

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu, kryesues, anëtarët Isa Shala e Rafet Haxhaj, (më tej kolegji) në çështjen juridike të paditësit M.N. nga ... Komuna e Vitisë, i përfaqësuar nga V.M. av. në Viti, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN” me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga A.L., për kompensimin e dëmit jo material dhe material, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, C.nr.269/2010 të datës 10.07.2013, pas mbajtjes të seancës së kolegjit, me datë 18.05.2016 jep:

A K T G J Y K I M

Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, C.nr. 269/2010 i datës 10.07.2013, ashtu që gjykohet:

Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material të pësuar si pasojë e aksidentit në komunikacion i cili kishte ndodhur më dt. 06.11.2010, në fshatin Sllatinë, që paditësit M.N., t’i paguajë si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

Për dhembje fizike shumë prej 2.800 €, për frikë shumë prej 2.600 €, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 8.500 € si dhe për shëmtim të lehtë trupor shumë prej 1.000 €. Përtej shumave të gjykuara si në këtë paragraf për këto forma të kompensimit të dëmit kërkesëpadia e paditësit kundër të paditurës **refuzohet** e në shumë prej 7.100 € si dhe kamatëvonesa në këtë shumë.

Ndryshohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë për kamatëvonesën i dhënë në aktgjykimin ankimor dhe gjykohet me kamatëvonesë për të gjitha shumat e gjykuara për kompensimin e dëmit jo material si për mjetet e depozituara të banka mbi një vit pa destinim të caktuar.

Ndryshohet paragrafi 2 i dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë që ka të bëjë me vendimin për shpenzimet procedurale dhe gjykohet: E paditura ka për detyrë që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale ti paguaj shumë prej 600 €, ndërsa përtej shumës së gjykuar e në shumë prej 394,42 €, kërkesa e paditësit për shpenzime procedurale, **refuzohet** si e pathemeltë.

Paragrafët e aktgjykimit ankimor që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material si dhe për pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit kundër paditurës, nuk janë shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti, me aktgjykimin C.nr.269/2010 të datës 10.07.2013, ka vendosur si vijon:

“Miratohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.N. nga fshati ..., Komuna e Vitisë dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” me seli në Prishtinë që paditësit t’ia kompensoj dëmin material dhe jo material për aksidentin e pësuar me datë 06.11.2010, me ç’ rast kishte pësuar lëndim të rëndë trupor, andaj duhet t’i kompensohet dëmi në këto baza: Kompensimi i dëmit material: për dhembjet fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, për disa sekonda, shumën prej 1.800 €, për dhembjet fizike të intensitetit të lartë, për 5 ditë, shumën prej 2.800 €, për dhembjet fizike të intensitetit të mesëm, për 50 ditë shumën prej 3.700€, për dhembje fizike të intensitetit të ulët, ku edhe sot ka dhimbje shumën prej 600 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor i shprehur në shkallën prej 37,5% shumën prej 9.500€, për shëmtim të lehtë trupor 2000 €, për frikën e përjetuar sekondare të intensitetit të lartë për 7 ditë, të mesëm për 3 muaj dhe të ulët për 1 vit, shumën prej 3.400 €, gjithsej dëmi jo material 23.800,00 €(njëzet e tremijë e tetëqind euro). Kompensimi i dëmit material: Shpenzimet materiale të faturave për barna dhe shërbime transporti, shumën prej 1.866,75 € (njëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e shtatëdhjetë e pesë cent). Gjithsej dëmi jo material dhe material është 25.666,75 € (njëzet e pesëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e shtatëdhjetë e pesë cent). Të gjitha me kamatë prej 8%, duke e llogaritur nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, deri në pagesën përfundimtare, nën kanosjen e përmbarrimit të dhunshëm. Detyrohet e paditura që t’ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: 101 € për përpilimin e padisë, 26 € për pagimin e taksës në padi, 486,72 € për përfaqësim në katër seanca gjyqësore, 300,70 € për shpërblimin e ekspertëve për dy ekspertiza dhe 80 € për precizime kërkesëpadië, apo gjithsej 994,42 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Refuzohet kërkesëpadia për pjesën prej 13.233,25 €, sa i përket kompensimit për dëmin jo material, si e pabazuar.”

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i të paditurës A.L., me dt. 19.11.2013, ka paraqitur ankesë me të cilën ka kërkuar që ankesa e të paditurës të aprovohet dhe aktgjykimi ankimor të kthehet në rivendosje dhe rigjykim, duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje esenciale të dispozitave të LPK, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.*

Përfaqësuesi i paditësit me parashtrësën e dt. 26.11.2013 është përgjigjur në ankesë, duke pohuar se aktgjykimi ankimor është i drejtë dhe i bazuar në ligj, ndërsa pretendimet ankimore të të paditurës janë të pa themelta duke propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet, ndërsa aktgjykimi ankimor të vërtetohet.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit: Kolegji, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, e në bazë të shkresave të lëndës vlerësoi se ka juridiksion për procedim dhe vendimmarrje në këtë çështje juridike, duke u bazuar në nenet 17.1, 18.1 e 19.1 të Ligjit për Gjykatat, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 79/2010”).

Vlerësimi formal i ankesës: Nga shkresat e lëndës (Fletë kthesa mbi dorëzimin e aktgjykimit si dhe vula e pranimit në kopjen e ankesës) rezulton se ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë është paraqitur brenda afatit ligjor, ajo përmban elementet e parapara me ligj, si dhe është paraqitur për shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi i shkallës së parë.

Kolegji, vlerëson se ankesa i përmbush kërkesat ligjore nga nenet 176 e 178 lidhur me nenin 186 të Ligjit për Procedurën Kontestimore i Kosovës nr.03/L-006 (më tej LPK) pra ajo është e lejueshme, është paraqitur brenda afatit dhe është e plotë, dhe si e tillë është e pranueshme.

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e themeltë.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182 par.2 nën par. b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, drejtë dhe plotësisht ka konstatuar gjendjen faktike, si dhe nuk ekzistojnë shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 197 i LPK.

Nga gjendja në dosje rezulton se gjykata e shkallës së parë në seancën gjyqësore për konstatimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka marrë provat e përshkruara në arsyetimin e aktgjykimit ankimor dhe ka konstatuar gjendjen faktike si vijon:

Se më dt. 06.11.2010 në rrugën ... – Sllatinë e Ulët, rreth orës 19:00 kishte ndodhur aksident komunikacioni, ku pjesëmarrës në aksident ishin vetura e markës WV Golf, vp 1998 me targa 344-KS-376, të cilën e drejtonte Kadri Sefedini dhe këmbësori tani paditësi, M.N. i moshës 65 vjeçare nga fshati ..., me ç ‘rast paditësi kishte pësuar lëndime të rënda trupore si pasojë e të cilave kishte pësuar dhembje fizike dhe frikë të intensitetit dhe kohëzgjatjes së përcaktuar nga ekspertet kompetent, kishte pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 37,5% si dhe shëmtim trupor të shkallës së lehtë. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë aksidenti ishte shkaktuar me fajin e të siguruarit të paditurës.

Përfaqësuesi i të paditurës e kishte kontestuar bazën e kërkesëpadisë si dhe lartësinë e saj, duke pohuar se ekziston përgjegjësia e pjesëtuar pasi që paditësi ka kontribut në shkaktimin e dëmit sepse sipas vlerësimit të ekspertit dhe gjendjes faktike ai ka lëvizur në anën e djathtë të rrugës, pra kthyer me shpinë nga drejtimi i lëvizjes së veturës.

Sipas vlerësimit të ekspertit të komunikacionit paditësi kishte kontribut në shkaktimin e dëmit sepse ai kishte lëvizur skajit të rrugës maksimalisht deri në gjysmë metër nga skaji i rrugës, që sipas vlerësimit të ekspertit përfaqëson një kontribut prej 10 deri 20 %, ndërsa kontributi i drejtuesit të veturës – të siguruarit të paditurës është 80 deri 90 % (deklarimi i ekspertit në seancën për shqyrtimin kryesor si dhe në raportin e tij në formë të shkruar).

Në bazë të kësaj gjendje të çështjes gjykata e shkallës së parë kishte vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, me arsyetim se janë përmbushur kërkesat ligjore që e paditura të kompensoj dëmin ndaj paditësit.

Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i të paditurës në ankesën e parashtruar, ka pohuar se në bazë të vlerësimit të ekspertit kompetent ekziston përgjegjësia e pjesëtuar sepse paditësi ka kontribut në shkaktimin e dëmit pasi që ai ka lëvizur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për komunikacionin rrugor. Shumat e gjuhuara janë në kundërshtim me kriteret e zbatuara për gjykim, nga gjykatat, në raste të ngjashme aksidentale, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, pasojat dhe kontributin e paditësit në këtë rast.

Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë, në këtë rast në bazë të provave që i ka marrë gjatë shqyrtimit të çështjes në shkallë të parë, nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, pasi që në këtë rast paditësi ka kontribut në shkaktimin e dëmit, duke lëvizur në shiritin rrugor në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe se shpërblimi i dëmit në kuptim të nenit 192 të LMD i takon në përpjesëtim të zvogëluar me kontributin e tij.

Pra gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar gabimisht gjendjen faktike, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale për çka gjykata e shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Me nenin 201 të LPK është përcaktuar: “Gjykata e shkallës së dytë nëse në seancën e kolegjit ... me aktgjykim e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë nëse b) me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të marra në mënyrë indirekte, ka konstatuar gjendje tjetër faktike nga ajo e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë.”

Pra nga kjo dispozitë ligjore rezulton se gjykata e shkallës së dytë në bazë të konstatimit të gjendjes tjetër faktike nga ajo e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë, duke konstatuar se edhe paditësi kishte kontribut në shkaktimin e dëmit, vlerësoj se duhet ndryshuar aktgjykimi ankimor edhe sa i përket kontributit të paditësit në shkaktimin e dëmit si dhe sa i përket zbatimit të së drejtës materiale, pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë shumat e gjuhuara në dispozitivin e aktgjykimit të saj të cilat është detyruar që e paditura t’ia paguajë paditësit për të gjitha format e shpërblimit të dëmit jo material, janë në s’përputhje me vlerat monetare, që sipas praktikës gjyqësore të gjykatave në Kosovë janë aprovuar për këto forma të shpërblimit të dëmit. Pra në këtë rast gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale e që në bazë të nenit 201 par d) dhe e) të LPK vlerësoi se aktgjykimi i shkallës së parë edhe në këtë drejtim duhet ndryshuar.

Kështu kolegji, vlerëson se, duke marrë për bazë natyrën e lëndimeve trupore, dhembjet e përjetuara fizike, frikën, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, shkallën e zvogëlimit

të aktivitetit jetësor dhe shkallën e shëmtimit trupor, si dhe kontributin e paditësit në shkaktimin e dëmit, shumat e gjykuara si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë, që e paditura ka për detyrë që në emër të kompensimit të dëmit jo material, t'i paguajë paditësit M.N., përfaqësojnë kompensim të drejtë dhe satisfaksion adekuat që ai më lehtë t'i përballojë dëmin jo material të përjetuar si pasojë e ngjarjes aksidentale.

Baza ligjore e të drejtës për kompensim, në këtë rast buron nga dispozitat ligjore të neneve 154, 178.2, 192 dhe 200 të LMD.

Me paragrafin 2 të nenit 200 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr. 29/78), si Ligj i zbatueshëm në Kosovë, në bazë të UNMIK Rreg. 1999/24, në momentin e shkaktimit të dëmit, (me tej LMD), është përcaktuar:

"Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysht rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror".

Ndërsa me nenin 192 të LMD është përcaktuar: *"I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa do të ishte zakonisht, ka të drejtë vetëm në kompensimin përpjesëtimisht të pakësuar".*

Ndërsa legjitimiteti pasiv i të paditurës KS "NN" për kompensimin e dëmit ndaj palës paditëse, në këtë rast buron nga neni 919.1 i LMD me të cilën është përcaktuar: *"Kur të ketë ndodh rasti i siguruar, siguruksi ka për detyrë të paguajë shpërblimin..."*. Ndërsa i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes në shkallë të parë e as në procedurë sipas ankesës, nuk provoi se siguruksi në këtë rast ishte i përjashtuar nga përgjegjësia sipas bazës ligjore të nenit 920 të LMD.

Sa i përket vendimit për kamatë vonesën ai është ndryshuar pasi që shkaktimi i dëmit ka ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri për Marrëdhëniet e detyrimeve, ndërsa lartësia e kamatëvonesës dhe e drejta në kamatëvonesë në këtë rast buron nga neni 277 i LMD së vjetër.

Sa i përket paragrafëve që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material si dhe për pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit kundër të paditurës që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material aktgjykimi ankimor nuk është shqyrtuar sepse paragrafët përkatës të aktgjykimit të shkallës së parë nuk ishin të goditur me ankesë, e që në kuptim të nenit 194 të LPK gjykata nuk ka kompetencë që t'i ekzaminoj pjesët e aktgjykimit të shkallës së parë, të cilat nuk janë të goditura me ankesë.

Sa i përket paragrafit të vendimit të aktgjykimit ankimor që ka të bëjë me shpenzimet procedurale, gjykata e shkallës së dytë e ndryshoi vendimin për shpenzimet, duke marrë parasysht suksesin e palëve në procedurë e në bazë të nenit 452.2.5 të LPK, si dhe faktin se pala paditëse në këtë rast ishte përfaqësuar nga avokati.

Më sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga neni 201 b), d) dhe e) të LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
CA.nr.4130/2013 dt. 18.05.2016

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari,
Gani Avdiu